



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/Inspektorat Rada/Labour Inspectorate

Bazuar në nenin 94 të Ligjit Nr.03/L-121 i Punës , neni 24 të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë , dispozitave të nenit 4 dhe neni 6 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës , Ligjit nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9 , dispozitat e nenit 132 të Ligjit Nr.05/L-031 të LPPA dhe Aktgjykimit nr. K027/21 i dt. 16.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ,Organi i Shkallës së Dytë në Inspektoratin e Punës në përbërje të : Hekuran Nikçi – Kryeinspektor dhe zyrtarët përgjegjës për zhvillimin e procedurës : Murat Vokshi dhe Behram Latifi duke vendosur sipas ankesës të dt.29.08.2023 me e palës në procedurë „Telekomi i Kosovës” Sh.a ,me adresë në Dardania pn. 10000 - Prishtinë e ushtruar kundër Vendimit Nr.01/50/198/2023GJ i dt.16.08.2023 i Organit të Shkallës të Parë të Inspektoratit të Punës , marrin këtë :

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar ankesa dt.29.08.2023 e palës në procedurë „Telekomi i Kosovës” Sh.a me adresë në Dardania pn. 10000 - Prishtinë e ushtruar kundër Vendimit Nr.01/50/198/2023-GJ i dt.16.08.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës.
- II. **VËRTETOHET** Vendimi Nr.01/50/198/2023 i dt.16.08.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës.

Arsyetim

Inspektorati i Punës në rajonin e Prishtinës, si organ i shkallës parë ka realizuar inspektim lidhur me ankesën, e palës ankuese Blerim Balaj të datës 30.05.2023 me prot.374/2023 në subjektin në procedurë „Telekomi i Kosovës”Sh.a me adresë në Dardania pn. 10000 - Prishtinë, ku pas inspektimit lidhure pretendimet ankimore te palës, me konstatimet në Raport Zyrtar Nr.50-165/2023, Nr.01.Nr.150-198/2023,dt.31.07.2023, ka nxjerr Vendimin Nr.01/50/198/2023GJ i dt.16.08.2023, me të cilin i ka shqiptuar masën ndëshkimore gjobë në vlerë prej 5000,00 € (Pesëmijë €) palës në procedurë „Telekomi i Kosovës” Sh.a me adresë në Dardania pn. 10000

- Prishtinë pasi është vlerësuar përgjegjës për shkelje të Nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës , për shkelje të Nenit 10 dhe nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës .

Pala ankese „Telekomi i Kosovës” Sh.a me adresë në Dardania pn. 10000 – Prishtinë ka ushtruar ankesë e dt.29.08.2023 kundër Vendimit Nr.01/50/198/2023 i dt.16.08.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës me pretendime ankimore : *shkelje esenciale të procedurave administrative , vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike , aplikim të gabuar të drejtës materiale dhe tejkallim të kompetencave.*

Organit të shkallës së dytë IP-së, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës të prezantuar dhe vendimin e shkallës së parë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesën e ankuesit gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës ka bërë vlerësimin dhe shqyrtimin e të gjitha provave , pretendimeve ankimore; Vendimi me 01/NR.50-198/2023-Gj,Raporti Zyrtar Nr.50-165/2023,Raporti Ri inspektimit Nr.01.Nr.150-198/2023,dt.31.07.2023,Ankesa e palës Blerim Bala, Konkurs pune, Vendimi i përzgjedhjes, njoftimi konditave ,Kontrata e punës, Vendimi i formimit të Komisionit ,komunikimet elektronike ,njoftimi i përzgjedhjes dhe vendimin e atakuar dhe nuk është gjetur ndonjë dëshmi e cila do të dëshmonte që ankuesi Pala në procedurë „Telekomi i Kosovës” Sh.a me adresë në Dardania pn. 10000 – Prishtinë nuk është përgjegjës për shkelje dispozitave të përgjegjës për shkelje të Nenit 8 paragrafi të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës , për shkelje të Nenit 10 dhe nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës . Vendimit atakuar, është i përpiluar në harmoni me dispozitën e nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 Procedurës Përgjithshme Administrative, sepse vendimi përmban: bazën ligjore të vendimit, argumentin e arsyes pse është e zbatueshëm në rastin konkret, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi duke u bazuar në obligimet ligjore.

Organi i Shkallës së dytë , shqyrtoj pretendimet ankimore të palës procedurë Telekomi i Kosovës” Sh.a me adresë në Dardania pn. 10000 – Prishtinë dhe dokumentacionin e ofruar dhe konstatoi se Vendimi Nr.01/50/198/2023 i dt.16.08.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës është marr dhe përpiluar në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative , vendimi posedon qartë bazën ligjore , ka dhënë argumentet dhe ka konstatuar se në rastin konkret ka ndodhur shkelje të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës , për shkelje të Nenit 10 dhe nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës të njëjtit Ligj.

Në pretendimin ankimor në ankesën e ankuesit për tejkallim të kompetencave ligjore Inspektori i Punës ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore : Inspektori i punës ka pranuar ankesën fillestare në mbështetje ligjore në Ligjin Nr.03/L-212 i Punës në kuptim të dispozitës të nenit 82 dhe 94 dhe 83 të këtij Ligjit si dhe Ligji Nr.03/L – 017 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/9 Inspektoratit të Punës në piken (c) paragrafi 5 i nenit 5 riformulohet si vijon:

“ Shënojnë me anë të raportit zyrtar , mos respektimin apo shkeljen e dispozitave ligjore.

Inspektori i punës me vendim shqipton gjobën”.

Nga ligjet kryesore që mbikëqyrë Inspektorati i Punës është Ligji Nr.03/L-212 i Punës, i cili ligj zbatohet për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.

Nga ligjet kryesore që mbikëqyrë Inspektorati i Punës është Ligji Nr.03/L-212 i Punës, i cili ligj zbatohet për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.

Dispozita e nenit 82 {Mbrojtja e të punësuarit nga Inspektorati i Punës} të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës përcakton se;

1. I punësuarit në çdo kohë mund t'ia dorëzojë ankesën Inspektoratit të Punës për çështje të cilat bien nën kompetencat e këtij organi.

Inspektorati i Punës për kërkesat e të punësuarve që janë në juridiksionin e tij sipas Ligjit Nr.03/L-121 të Punës përkatësisht Nenit 83 përcaktohet se: *Masat ndëshkuese Për shkeljen e dispozitave të këtij ligji nga ana e punëdhënësit, Inspektorati i Punës do t'i shqiptojë masat ndëshkuese bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës.* Bazuar në Ligjin e Punës dhe atë të Inspektoratit, është plotësisht i qartë fushëveprimi i kompetencës së Inspektoratit të Punës, i cili si trup inspektues dhe mekanizëm i pushtetit ekzekutiv, mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës ndërmjet të punësuarit dhe punëdhënësit dhe mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në kuadër të fushëveprimit që përcakton Ligji për Inspektoratin: (i) zbatimin e masave ndëshkuese (gjobave) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit. Po ashtu duke marr parasysh edhe që në një rast tjetër të një kompanie publike Gjykata komerciale me Aktgjykimi me .K.A.nr.188/22 dt.30.06.2023,ka refuzuar kërkesëpadinë e palës lidhure me vendimin e inspektoratit te punës lidhure shkeljet e dispozitave të Udhëzimit Administrative 07/2017,lidhure me shqiptimit e mase ndëshkimore gjobë për shkak shkeljeve te nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligji Nr.03/L-212 i Punës, dhe vlerëson se Inspektorati i Punes ka vërtetuar ne mënyre te drejt dhe te sakte gjendjen faktike duke u mbështetur ne të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës , Ligjit nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9.

Pretendimet ankimore te palës me ankesë me dt.29.08.2023,nuk janë te mbështetura ne prova dhe fakte ,se gjatë inspektimit janë konstatuar shkelje ligjore, ju është dhëne afati për eliminimin e parregullsive në aftin pesë (5) ditë, këto pretendime nuk qëndroje pasi raporti zyrtarë e vërteton te kundërtën, raporti zyrtar të ri-inspektimit është me date 16.08.2023, ku punëdhënësi është njoftuar me parregullsitë edhe vërejtje lidhure me konstatimet në rastin e inspektimit, Vendimi Nr.01/50/198/2023 i dt.16.08.2023 të i Inspektorit të Punës lidhure me shqiptimin masës ndëshkimore gjobë palës në procedurë. Pretendimi ankimor lidhure me shfuqizimit e Udhëzimit Administrative 07/2017,nuk qëndron se ky udhëzim është ne fuqi edhe i zbatueshëm dhe e rregullon procedurën e themelimit te marrëdhënie se punës ne sektorit publik ,ky udhëzim derivon nga Ligji Nr.03/L-121 të Punës, kompanitë Publike janë të përjashtuar nga ligji për Zyrtar Publik NR.06/L-16-114 i cili ka qenë në fuqi , d.m.th. nuk i nënshtrohen dispozitat e këtij ligji dhe çështjet nga marrëdhënia e punës rregullohen me anë të Ligjit Nr.03/L-121 të Punës.

Për arsyet e cekura më lartë Organi i shkallës së dytë i IP-së gjeti se në vendimin e kundërshtuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj pretendimet ankimore të ushtruara nga pala në procedure janë jo bindëse dhe si të tilla refuzohen. Sepse bëjnë një arsyetim jo bindës për konstatimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e dispozitave ligjore, sepse

të gjitha faktet që i përshkruan në ankesë dhe i kanë sjellë me ankesë janë fakte që i janë shqyrtuar në këtë procedurë edhe nga Organi i Shkallës së parë të Inspektoratit të Punës, fakte të cilat i shqyrtoi edhe Komisioni i Organit të shkallës së dytë dhe vlerësoi se inspektori i punës drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore, drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat i aprovoi edhe Organi i Shkallës së Dytë i IP-së .

Organi i Shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës gjeti se në vendimin e atakuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë , ndërsa pretendimet ankimore të ushtruara nga pala në procedurë janë jo bindëse të pa vërtetuara me prova prandaj edhe Organi i Shkallës së dytë vendosi që ta refuzoj ankesën si të pa bazuara dhe ta vërtetoj Vendimin Nr.01/50/198/2023GJ i dt.16.08.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës .

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

V.V

Kryeinspektori i Punës
Hekuran Nikçi

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi mundë të ngritët kontest administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar palës në procedurë

1x2 Inspektoratit të Punës